

S T A T U T I

I

**SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
„KOMUNALNO / KOMUNALE,, TUZ**

Dhjetor 2021

Në bazë të nenit 271 dhe 329 të Ligjit mbi shoqëritë afariste (“Fleta Zyrtare e MZ”, nr. 065/20, nga 03.07.2020) dhe nenit 16 të vendimit mbi themelimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar ”Komunalno / Komunale” Tuz (Fleta Zyrtare e MZ – dispozitat komunale nr. 033/19, 040/21), Bordi i drejtorëve të SH.P.K ”Komunalno / Komunale” Tuz, në seancën e mbajtur më 29.12.2021, sjellë:

S T A T U T I

I

SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR „KOMUNALNO / KOMUNALE,, TUZ (Tekst i konsoliduar)

I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Themelues i Shoqërisë është Komuna e Tuzit, Tuz pn. Numri amëz 02628988.

Komuna është pronari i vetëm i Shoqërisë (shoqëri një anëtaresh-e) dhe disponon njëqind për qind me gjithë pasurinë e shoqërisë, pa pasur mundësi të kalimit të ndonjë pjese të pasurisë te personi i tretë.

Shoqëria themelohet në punë me kohë të pacaktuar.

Neni 2

Shoqëria vepron e pavarur në qarkullimin juridik, lidhë kontrata dhe kryen punë të tjera juridike.

Shoqëria përgjigjet për obligime ndaj personave të tretë, me gjithë pasurinë e saj. Themeluesi përgjigj për obligimet e Shoqërisë deri në lartësinë e rolit të saj.

II EMRI DHE SELIA E SHOQËRISË

Neni 3

Shoqëria vepron nën emërtimin Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar „Komunalno / Komunale” Tuz.

Shkurtesa e emërtimit të Shoqërisë është „Komunalno / Komunale” Sh.p.k. Tuz.

Neni 4

Selia e Shoqërisë është në Tuz, Tuz rr.12 nr.2.

III VULA E SHOQËRISË

Neni 5

Shoqëria ka vulën dhe vulën katrore.

Vula është e formës rrethore, me diametër 30mm në të cilën sipas shtypjes është shkruar teksti: Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar „Komunalno / Komunale” Tuz dhe në mes logon e Shoqërisë.

Vula katrore është e formës së drejtkëndëshit me dimension 60 x 30 mm, e cila përmban tekstin: Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar „Komunalno / Komunale” Tuz, hapësirën për numër të akitit dhe data e regjistrimit.

Ruajtjen, shfrytëzimin, evidencën, shpërbërjen e vulave dhe vulave katrore e kontrollon drejtori ekzekutiv i Shoqërisë.

Neni 6

Vula shërben për vërtetimin e autenticitetit të akteve të Shoqërisë, ndërsa vula katrore për pranimin e akteve.

Neni 7

Shoqëria ka shenjen e vet – logon.

Pamja – dizajni i shenjës (logos) së Shoqërisë përcaktohet nga Bordi i drejtoreve.

Bordi i drejtoreve mund të shpallin konkurs për zgjedhjen e pamjes së shenjës (logos) së Shoqërisë.

Neni 8

Në qarkullimin juridik, marrëdhëniet zyrtare dhe shkrimet me personat fizik dhe juridik, Shoqëria shfrytëzon memorandumin.

Memorandumi në pjesën e sipërme përmban shenjen-logon, emrin e shoqërisë dhe të dhëna të tjera në pajtim me Ligjin.

IV VEPRIMTARITË E SHOQËRISË

Neni 9

Shoqërisë i besohen kryerja e e veprimtarive komunale si vijon:

- Grumbullimin e mbetjeve të parrezikshme, si veprimtari kryesore, në Ligjin mbi kualifikimin e veprimtarive të përcaktuara në sektorin E, fusha 38, dega 38.1, grapi 38.11,
- mirëmbajtja dhe pastrimi i sipërfaqeve publike,
- mbledhja, transporti dhe shkarkimi I mbetjeve komunale për nevojat e shfrytëzuesve të shërbimeve, dhe
- mbledhja dhe tregtimi i lëndëve të dyta.

Shoqëria kryen veprimtari komunale, të parapara me Ligjin mbi kualifikimin e veprimtarive (Fl.Z e MZ“, numër 18/11) si veprimtari kryesore dhe ato:

38.1 – Mbledhja e mbetjeve,

38.11 – ripërdorimin e materialeve të mbeturave,

39 – Pastrimin e ambientit jetësor dhe aktivitete të tjera në lidhje me menaxhimin e mbeturinave,

81.3 – Shërbimet e mirëmbajtjes,

Veprimtaritë nga prg.1 i këtij neni janë veprimtaritë e interesit publik.

52.21 – veprimtaritë në shërbimin e komunikacionin tokësor i kryen aktivitetet lidhur me punën e parkingjeve dhe garazheve, dhe ato:

- me drejtimin e parkingjeve dhe garazheve,
- kryerjen e pagesës së kompensimeve dhe taksive lidhur me shfrytëzimin e vendeve të parkimit të parkingjeve dhe garazheve publike.
- ndërmarrja e masave dhe aktivitetet në mirëmbajtjen e vend-parkingjeve ekzistuese dhe garazheve publike si dhe në ndërtimin e përmbajtjeve të reja të vendeve të parkimit dhe garazheve publike.

Shoqëria përvëç veprimtarive nga paragrafi 1, mund të kryej edhe veprimtari të tjera të cilat përcaktohen me Statut të shoqërisë.

Veprimtaritë nga paragrafi 2 i këtij neni janë veprimtari të interesit publik.

Pranë veprimtarive nga neni 6 paragrafi 2 i këtij vendimi Shoqëria kryen edhe veprimtari të cilat nuk janë veprimtari të interesit publik, dhe ato:

- mirëmbajtja dhe përmirësimi i mjeteve motorike,
- veprimtaria e agjencioneve reklamuese,
- huazimi i pasurive të patundshme të veta dhe jo të veta dhe menaxhimi i tyre,
- veprimtari të tjera të shërbimeve personale.

96.03 shërbime funerale dhe të ndërlidhura:

- përgatitja për varrim dhe shërbime të tjera funerale,
- shërbime të varrimit,
- qiradhënie e sipërfaqes së pajisur të varrezave për varrime,
- qiradhënia dhe shitja e vendvarrimeve,
- mirëmbajtja e varreve dhe monumenteve përkujtimore.

Për veprimtaritë nga paragrafi i mëparshëm Shoqëria udhëheqë evidencë regjistrimi të veçantë.

Shoqëria afariste në fushat për të cilat është themeluar kryen punët si në vijim:

43.91 – punët e çative:

16.23 – Prodhimi i mobilierisë së ndërtimit dhe pajisjeve;

22.23 – Prodhimi i lendeve nga plastika për ndërtimtar;

25.12 – Prodhimi i dyerve dhe dritareve metalike;

33.14 – Ndreqja e pajisjeve elektrike;

41.20 – Ndërtimi i ndërtesave të banimit dhe të tjera;

43.11 – Shembje e objekteve;

43.12 – Përgatitja e vend ndërtimeve;

43.21 – Instalimet elektrike;

- mirëmbajtja e ndriçimit publik,

- mirëmbajtja e sinjalistikës ndriçuese dhe

- mirëmbajtja e orëve publike.

43.29 – Instalime të tjera në ndërtimtar;

43.31 – Suvatim;

43.32 – Instalim i mobilierisë;

43.33 – Vendosja e mbulesave të dyshemesë dhe murit;

43.34 – Ngjyrosje dhe vendosje të xhamave;

43.39 – Punë të tjera përfunduese;

43.99 – Punë të tjera specifike të ndërtimit që nuk janë përmendur;

46.13 – Ndërmjetësimi në shitjen e lëndëve të drurit dhe materialit ndërtimor;

46.73 – Tregtimi me shumicë i drurit, me materialet ndërtimore dhe me pajisje sanitare;

46.74 – Tregtimi me shumicë me mallra metalike, me materialet ndërtimore, pajisje për nxemje;

49.41 – Transport rrugor i mallrave;

49.42 – Shërbime të zhvendosjes;

52.21 - Veprimitari të shërbimeve në komunikacionin tokësor.

68.10 – Blerja dhe shitja e patundshmërive të veta;

68.20 – Dhënia me qira e patundshmërive të të veta ose të marra në qira dhe menaxhimi i tyre;

68.31 – Veprimitaria e agjencioneve për patundshmëri;

68.32 – Menaxhimin e patundshmërive kundrejt kompensimit;

71.11 – Veprimitari arkitektonike;

71.12 – Veprimitari inzhenjerike dhe këshille-dhënie teknike;

77.32 – Dhënia me qira dhe në lizing e makinerisë për ndërtimtarit;

81.21 – Shërbimet e pastrimeve të rregullta të ndërtesave;

81.22 – Shërbimet e pastrimeve të tjera të pajisjeve dhe ndërtesave;

96.09 - Shërbimet e kujdesit për kafshët shtëpiake;

81.30 - rregullimi dhe mirëmbajtja e rrethinës,

- Mirëmbajtja, përkujdesja dhe përtëritja e fondit bimor,
- Mirëmbajtja, pajimi dhe pastrimi i parqeve dhe sipërfaqeve të gjelbra publike,
- Mirëmbajtja dhe pastrimi i sipërfaqeve për rekreacion, plazheve të hapura dhe brigjeve të lumenjve,
- Ndërmerr masa për mbrojtjen e gjelbërimit publik, nga insektet, sëmundjet e bimëve dhe katastrofave natyrore,
- Rritja dhe prodhimi i materialeve për mbjellje (fidanë), së paku deri në nivelin e riprodhimit për veprimitarinë themelore,
- Pastrimin e brigjeve dhe kanaleve kulluese dhe atyre të hapura.
- Mirëmbajtjen e rrugëve lokale Shoqëria do ta kryej në kufijtë e mjeteve të parapara për atë veprimitari, me çka duhet të plotësohen kushtet minimale për kryerjen e sigurt të komunikacionit.

- Drejton, jep me qira dhe mirëmban ndërtesat e banimit dhe pjesët e veçanta të ndërtesave të banimit të cilat janë pasuri e Kryeqytetit;

- Udhëheqë regjistrin e pronarëve etazhor, regjistrin e ndërtesave t banimit dhe pjesëve të tyre të veçanta;

- Kryen punime emergjente, nëse organi udhëheqës i ndërtesës së banimit nuk siguron kryerjen e këtyre punëve;

- Përllogaritë shumën dhe përcakton mënyrën e pagesës së shpenzimeve për mirëmbajtjen e e ndërtesës së banimit, me aktvendim, në pajtim me vendimin e kuvendit të pronarëve etazhor,

- Ofron shërbime të mirëmbajtjes së ndërtesës së banimit, sipas principit të tregut, ndaj personave të tretë.

96.03 - ofrimin e shërbimeve funerale,

- Mirëmbajtja e varreve,
- Rregullimi i varreve,
- Dhënia me qira dhe shitja e vendvarrimeve,

96.09 – përkujdesja dhe trajtim i kafshëve të braktisura shtëpiake,

- Përkujdesje ndaj kafshëve të braktisura dhe të lëshuara ose kafshëve të humbura dhe mirëmbajtja e strehimoreve për përkujdesjen e tyre,

- Mbledhjen, transportin e kafshëve nga pronat publike si dhe asgjësimin e mushkonjave dhe brejtësve.

Veprimtaritë nga neni 9 janë veprimitari të interesit publik. Shoqëria është e obliguar të udhëheqin evidencën e posaçme, me vëmendje të posaçme në veprimtaritë të cilat financohen nga buxheti.

Neni 10

Krahas veprimitarive nga neni 6 i këtij Statuti, Shoqëria kryen edhe veprimitari të cilat nuk kanë karakter të veprimitarive të interesit publik dhe ato:

- 49.41 - ngarkim, transportim dhe largim të mbetjeve të parrezikshme sipas kërkesës së personave të tretë,
- 43.11 - largimin e objekteve, gërmime ndërtimi, dhe punë të tjera ndërtimi,
- 70.21 - punë menaxhimi dhe konsultimi,
- 71.1 - mbikëqyrjen për realizimin e punëve ndërtimore dhe të zanatit nga ana e personave të tretë,
- 36.60 - transport i ujërave teknike dhe larja e sipërfaqeve sipas kërkesës së personave të tretë,
- 71.12 - veprimitari inzhenjerike dhe këshillime teknike.
 - kryen punë të mirëmbajtjes së ndërtesave të banimit dhe banesave në bazë të marrëveshjeve të lidhura me organin drejtues të ndërtesës së banimit.

Për kryerjen e veprimitarive për të cilat nuk është në mënyrë kadrovike dhe teknike e përgatitur, Shoqëria do të angazhojë subjekte të tjera dhe institucione të specializuara të riregjistruar për kryerjen e atyre veprimitarive.

Për veprimitaritë nga neni 10 e këtij Statuti, Shoqëria është e obliguar të udhëheqin evidencë të posaçme.

Neni 11

Shoqëria nuk mund të kryej ndryshime në regjistrimin e veprimitarisë pa pëlqimin e Kuvendit të Komunës së Tuzit.

Vendimin për ndryshimin e regjistrimit të veprimitarisë e sjellë Bordi i drejtorëve me pëlqim të obliguar të Themeluesit.

KAPITALI THEMELOR

Neni 12

Kapitalin themelorë të Shoqërisë e përbën kapitali themelor i ndërmarrjes publike "Veprimitari komunal" Tuz, e cila është e regjistruar në regjistrin Qendoror të subjekteve afariste në Podgoricë.

Pasurinë e Shoqërisë e përbëjnë gjërat e tundshme dhe të patundshme, mjetet financiare dhe të drejta të tjera të pasurisë, të ndërmarra nga ana e shërbimeve publike të Komunës së Tuzit, vlerësimin e të cilës do ta kryej vlerësuesi i pavarur i autorizuar në pajtim me ligjin.

Neni 13

Financimi i veprimitarive të cilat kanë karakter të veprimitarive të interesit publik kryhet nga ana e të ardhurave vetjake të Shoqërisë, Buxhetit të Komunës dhe burimeve të tjera të cilat i përcakton Themeluesi në pajtim me ligjin.

Mjetet për kryerjen e veprimitarisë të cilat nuk kanë karakter të veprimitarisë së interesit publik sigurohen nga të ardhurat vetjake të Shoqërisë.

Neni 14

Rezultatet e punës dhe gjendja e mjeteve përcaktohet me përllogaritjen vjetore të Shoqërisë.

V ORGANIZIMI I BRENDSHEM

Neni 15

Veprimitaritë nga nenii 9 dhe 10 i këtij Statuti, Shoqëria i kryen në mënyrë që të sigurohet stabiliteti i punës, efikasiteti i drejtimit, si dhe ndërlidhë marrëdhënien e punës në përbërje të kushteve të tregut.

Neni 16

Me aktin për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës më afër përcaktohet: emërtimi i formave organizative; vendet e punës dhe numri i nevojshëm e punëtorëve; lloji dhe shkalla e përgatitjes profesionale; përvaja e punës; kushtet e posaçme në pajtim me ligjin; punë me autorizime të posaçme dhe përgjegjësi të posaçme si dhe çështje të tjera me rëndësi për organizimin e brendshëm dhe kryerjen e punëve nga veprimitaritë e Shoqërisë.

VI PËRFAQËSIMI DHE PREZANTIMI

Neni 17

Me Shoqëri drejton Themeluesi në mënyrë dhe me kushte të përcaktuara me Vendim dhe me këtë Statut të Shoqërisë përmes organit udhëheqës dhe drejtues dhe ata: Bordit të drejtorëve dhe Drejtorit ekzekutiv.

Neni 18

Themeluesi i Shoqërisë:

- jep pëlqimin në Statut të Shoqërisë;
- jep pëlqimin në ndryshimet e statutit;
- jep pëlqim në Tarifat e shërbimeve, të cilën përcakton bordi i drejtorëve me pëlqimin paraprak të siguruar të Agjencisë rregulluese për energji dhe themelues;
- jep pëlqim në zgjedhje dhe shkarkim të Drejtorit ekzekutiv;
- emëron dhe shkarkon anëtarët e bordit të drejtorëve;
- jep pëlqim në Programin vjetor të Shoqërisë;
- shqyrton Raportin vjetor financiar mbi punën e Shoqërisë dhe sjell vendime mbi shpërndarjen e fitimit dhe mënyrën e mbulimit të humbjes;
- sjell vendim mbi ndryshimin e emrit të veprimitarisë, selisë dhe kapitalit parësor të Shoqërisë dhe
- sjell vendim mbi ndryshimin e formës, ristrukturimit dhe likuidimit vullnetarë të Shoqërisë.

Neni 19

Bordi i drejtorëve, si organ drejtues i Shoqërisë, kryen funksionin e vet në interes të Shoqërisë dhe vepron me vëmendjen e afaristik të mirë.

Neni 20

Bordi Drejtues përbëhet nga 5 anëtarë.

Anëtarët e Bordit të Drejtorëve kryejnë funksionet e tyre me një tarifë mujore të përcaktuar.

Bordi i Drejtorëve mblidhet dhe merr vendime me shumicën e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Bordit.

Mënyra e emërimit të anëtarëve të Bordit Drejtues, të drejtat dhe detyrimet e tyre, mënyra e shkarkimit dhe kompetencat e tyre rregullohen me statutin e shoqërisë.
Bordi i Drejtorëve është përgjegjës për punën e tij para Themeluesit.

Neni 21

Anëtarët e Bordit të drejtorëve emërohen në periudhë prej katër viteve.

Anëtar i bordit të drejtorëve mund të dorëzojë kërkesë për pushimin e mandatit para skadimit të periudhës në të cilën është emëruar.

Kërkesa nga paragrafi dy i këtij neni parashtronhet Bordit të drejtorëve në formë të shkruar.
Kërkesa nga paragrafi dy i këtij neni i dorëzohet organit kompetent të Themeluesit.

Anëtar i bordit të drejtorëve mund të shkarkohet nëse:

- pa arsy nuk merr pjesë në punën e Bordit më gjatë se gjashtë muaj,
 - vepron në kundërshtim me nenin 19 të këtij Statuti dhe
 - në raste të tjera të përcaktuara me ligj.
- Propozimin për shkarkim mund të dorëzojë:
- kryetari i Bordit të drejtorëve,
 - anëtar i Bordit të drejtorëve të cilin e përkrahin së paku dy anëtar dhe
 - kryetari i Komunës.

Propozimin nga paragrafi një i këtij neni dorëzohet organit kompetent të Themeluesit, gjegjësisht Shoqërisë.

Neni 22

Konstituimi i Bordit të drejtorëve bëhet në seancën e parë, e cila duhet të mbahet në afat prej 7 ditëve, nga dita e hyrjes në fuqi të vendimit mbi emërimin e anëtarëve të Bordit të drejtorëve.

Neni 23

Bordi i drejtorëve sjellë Rregulloren e punës me të cilën më hollësisht përcaktohet procedura e caktimit të seancave, mënyra e punës dhe vendimmarrjes, në pajtueshmëri me ligj dhe aktin themelues.

Neni 24

Seancën e Bordit të drejtorëve e cakton kryetari i Bordit.

Seanca mund të caktohet në propozim të anëtarëve të Bordit të drejtorëve përderisa me propozim pajtohet më shumë se gjysma e të gjithë anëtarëve të Bordit.

Bordi i drejtorëve mblidhet në seanca dhe sjell vendime, nëse në seancë janë prezent më shumë se gjysma e anëtarëve.

Bordi i drejtorëve sjellë vendime me shumicën e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Bordit.

Anëtarë i Bordit nuk ka të drejtë të votojë kur Bordi vendosë mbi çështjet e përgjegjësisë së tij materiale apo tjetër.

Neni 25

Bordi i drejtues:

- menaxhon Shoqërinë dhe i jep udhëzime Drejtorit Ekzekutiv në lidhje me zhvillimin afarist të Shoqërisë,
 - miraton Statutin e Shoqërisë, me pëlqimin e themeluesit,
 - emëron Drejtorin Ekzekutiv,
 - i propozon themeluesit ndryshimin e kapitalit themelues,
 - përcakton politikën afariste të Shoqërisë dhe miraton akte për zbatimin e saj, në përputhje me udhëzimet e themeluesve,
 - kontroll dhe mbikëqyr menaxhimin e Shoqërisë,
 - miraton planin vjetor të punës dhe planin vjetor financiar, me pëlqimin e themeluesit,
 - i propozon themeluesit miratimin e raportit vjetor për zbatimin e planit vjetor të punës dhe pasqyrës financiare,
 - përcakton çmimin për shërbimet e Shoqërisë, me pëlqimin e themeluesit,
 - i propozon themeluesit shpërndarjen e fitimeve dhe mënyrën e mbulimit të humbjeve,
 - miraton akt për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, me pëlqimin e Kryetarit të Komunës,
 - përcakton politikat kontabël të Shoqërisë dhe politikat e menaxhimit të rrezikut,
 - jep dhe heq prokurën,
 - miraton raportet tremujore të Drejtorit Ekzekutiv mbi operacionet e Shoqërisë,
 - miraton rregulloren e punës së Bordit të Drejtorëve,
 - kryen edhe punë të tjera në pajtim me Ligjin dhe Statutin e Shoqërisë afariste.

Neni 26

Drejtori ekzekutiv është organ i cili udhëheq me Shoqëri.

Drejtorin ekzekutiv e emëron Themeluesi në bazë të shpalljes publike.

Procedura e shpalljes publike në emër të Themeluesit, e kryen Bordi i drejtorëve.

Mandati i Drejtorit ekzekutiv zgjatë katër vite me mundësin e riemërimit.

Neni 27

Për drejtor ekzekutiv mund të emërohet personi i cili pranë kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj, plotëson kushtet e mëposhtme:

- të ketë arsimin e lartë profesional,
- të ketë pesë vite përvjohës në punët e udhëheqjes, gjegjësish në punët e tjera të cilat kërkojnë pavarësi në punë.

Kandidati për drejtor të Shoqërisë është i obliguar që së bashku me fletëparaqitje në konkurs të dorëzojë edhe programin e punës së Shoqërisë për periudhën e mandatit.

Neni 28

Drejtori ekzekutiv, si organ i udhëheqjes së Shoqërisë:

- organizon dhe udhëheq punën e shoqërisë,

- përfaqëson dhe prezanton Shoqërinë,
- propozon aktet të cilat sjell Bordi i drejtorëve dhe është përgjegjës për zbatimin e vendimeve dhe akteve të tjera të Bordit të drejtorëve,
- vendos mbi të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e të punësuarve në pajtueshmëri me ligj,
- është përgjegjës për ligjshmërinë e punës së Shoqërisë dhe
- vendos mbi çështje të tjera lidhur me punën vijuese dhe punën e Shoqërisë në pajtueshmëri me Vendim, këtë Statut dhe dispozita të tjera.

Neni 29

Drejtori ekzekutiv mund të shkarkohet para skadimit të afatit në të cilin është emëruar për arsyet e mëposhtme:

- me kërkësë personale,
- nëse zbatimi i akteve të propozuara prej tij ka rezultuar në shkelje të të drejtave të punëtorit, ose nga faji ose mosveprimi i tij i kanë shkaktuar dëm Shoqërisë,
- nëse i tejkalon kompetencat në lidhje me të drejtat e përcaktuara me këtë Statut dhe aktet e tjera të Shoqërisë,
- pa arsy refuzon të zbatojë vendimin e Bordit të Drejtorëve ose të veprojë në kundërshtim me atë vendim,
- nëse, me vendim të formës së prerë të Gjykatës, i është i ndaluar të kryejë këto punë dhe
- në raste të tjera të parashikuara me ligj).

Neni 30

Iniciativën për nismën e procedurës për shkarkim të Drejtorit ekzekutiv të Shoqërisë mund të parashtrojë Bordi i drejtorëve dhe organi i Themeluesit i cili kryen mbikëqyrjen administrative mbi punën e Shoqërisë.

Bordi i drejtorëve është i obliguar që iniciativën për nismën e procedurës për shkarkimin e Drejtorit ekzekutiv të shqyrtojë, sjellë vendim dhe mbi atë të njoftojë parashtruesit e iniciativave, në afat prej 30 ditëve nga dita e dorëzimit të iniciativës.

Neni 31

Drejtori ekzekutiv lidh Konratë mbi punë me Bordin e drejtorëve më të cilën përcaktohen të drejtat, obligimet, përgjegjësitë dhe paga e Drejtorit ekzekutiv.

VII INFORMIMI DHE MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN

Neni 32

Puna e Shoqërisë është publike.

Shoqëria është e obliguar që mbi punën e vet rregullisht të njoftojë Themeluesin, me pasqyrat e kontabilitetit, veprimtarinë dhe punën e revizionit në mënyrën dhe kushtet e përcaktuara me ligj.

Drejtori Ekzekutiv i Shoqërisë, ose personi i autorizuar prej tij, është përgjegjës për sigurimin e informacionit mbi punën dhe veprimtarinë e Shoqërisë.

Neni 33

Të punësuarit në Shoqëri kanë të drejtë të jenë të informuar mbi të drejtat dhe detyrimet e veta, në bazë të punës përmes tabelës publike dhe ngjashëm.

Mbi informimin e të punësuarve përkujdeset dhe përgjegjës është Drejtori ekzekutiv i Shoqërisë.

VIII SEKRETI I BIZNESIT

Neni 34

Me sekret të biznesit nënkuptohen dokumentet dhe të dhënat e përcaktuara me vendim të veçantë të Bordit të drejtoreve, në pajtueshmëri me ligj, zbulimi i të cilave për personat e paautorizuar do të dëmtonte interesat dhe aktivitetet e Shoqërisë.

Dokumentet dhe të dhënat të cilat konsiderohen si sekret i biznesit duhet të shënohen si sekret i biznesit.

Sekretin e biznesit janë të detyruar të ruajnë të gjithë të punësuarit, pa marrë parasysh në cilën mënyrë kanë zbuluar sekretin e biznesit.

Shpalosja e paautorizuar e informacionit që është një sekret biznesi i Shoqërisë për sa i përket ligjeve dhe rregulloreve të tjera, këtij Statuti dhe akteve të tjera të Shoqërisë përbëjnë shkeljen detyrës së punës.

IX AKTET E SHOQËRISË

Neni 35

Aktet e Shoqërisë janë:

- Statuti, rregulloret dhe vendimet me të cilat në mënyrë të përgjithshme rregullohen çështje të caktuara, përderisa me ligj nuk është ndryshe e përcaktuar.

Neni 36

Shoqëria lidh Kontratë kolektive.

Kontrata kolektive nga paragrafi paraprak lidhet në mes të Bordit të drejtoreve, Drejtorit ekzekutiv dhe organizatës sindikale.

X NDRYSHIMET DHE PLOTËSIMET E STATUTIT

Neni 37

Vendimin mbi ndryshimin dhe plotësimin e Statutit sjell Bordi i drejtoreve në propozim të Drejtorit ekzekutiv të Shoqërisë, me pëlqim të Themeluesit.

Ndryshimet dhe plotësimet e Statutit bëhen në mënyrë dhe sipas procedurës së përcaktuar për sjelljen e tij.

XI PËRFUNDIMI I SHOQËRISË

Neni 38

Shoqëria përfundon me punë në raste dhe me kushte të përcaktuara me ligj.

XII DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 39

Aktet prej nenit 35 të këtij Statuti, do të sillen më së voni në afat prej 6 muajve prej ditës të përcaktuar me Shoqëri në Regjistrin qendrorë të subjekteve afariste, po qe e nevojshme. Deri në miratimin e akteve të reja të përgjithshme nga paragrafi 1. i këtij neni, zbatohen aktet e përgjithshme të Shoqërisë në fuqi.

Neni 40

Me hyrjen e këtij Statuti në fuqi, bëhet i pavlefshëm Statuti “Komunalno / Komunale” Tuz numër 5235 nga data 05.09.2019 si dhe Vendimi mbi ndyshimet dhe plotësimet e statutit shpk “Komunalno / Komunale” Tuz numër 1454/21 nga data 10.12.2021.

Neni 41

Ky Statut hyn në fuqi pas dhënies së pelqimit nga Themeluesi i Shoqërisë..

Numër: 152121
Tuz, 29.11.2021

BORDI I DREJTORËVE
SHPK “KOMUNALNO / KOMUNALE” TUZ
KRYETARI
Nikola Sinistar



A r s y e t i m

Baza ligjore:

Për miratimin e Statutit të Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "Komunalno / Komunale" Tuz është përfshirë në nenet 271 dhe 329 të Ligjit për shoqëritë afariste ("Fleta Zyrtare e MZ", Nr. 065/20, datë 03.07.2020) dhe nenit 16 të Vendimit për themelimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "Komunalno / Komunale" Tuz (Fleta Zyrtare e MZ - Dispozitat komunale nr.033/19, nr. 040/21), i cili parashikon se Bordi i Drejtoreve, të Shpk " Komunalno / Komunale "Tuz miraton Statutin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar" Komunalno / Komunale " Tuz.

Arsyet e adoptimit:

Neni 16 i Vendimit mbi themelimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "Komunalno / Komunale" Tuz (Fleta Zyrtare e MZ - dispozitat komunale nr.033/19, 040/21) parashevë detyrimin që Bordi i drejtoreve të Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "Komunalno / Komunale" Tuz, të miratojë Statutin e shoqërisë afariste, me pëlqimin e themeluesit.

Sic parashikon neni 271 të Ligjit mbi shoqëritë afariste ("Fleta Zyrtare e MZ", nr. 065/20, datë 03.07.2020) përbajtjen e parashikuar të statutit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, si dhe nenin 329 të ligjit për shoqëritë afariste ("Fleta Zyrtare e MZ", nr. 065/20, datë 03.07.2020), parashikonte detyrimin e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar që, në përputhje me këtë ligj, të harmonizojnë organizimin e tyre të brendshëm (statutin, organet e shoqërisë dhe aktet tjera) dhe të regjistrojnë ndryshimet.

Përbajtja e Statutit:

Në kapitullin I Dispozitat e përgjithshme – Përcaktohet themeluesi i Shoqërisë. Themeluesi i Shoqërisë është Komuna e Tuzit, Tuz pn. Komuna është i vetmi pronar i Shoqërisë (shoqëri një anëtarëshe) dhe disponon me qind për qind të aksioneve në shoqëri, me pa mundësi të kalimit të aksioneve në person të tretë. Shoqëria themelohet për punë në kohë të pa përcaktuar.

Në kapitullin II Emri dhe selia e Shoqërisë – Shoqëria vepron nën emër Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "Komunalno/Komunale" Tuz. Emri i shkurt i Shoqërisë është "Komunalno/Komunale" sh.p.k. Tuz.

Në kapitullin III Vula e Shoqërisë – Shoqëria ka vulën dhe vulën katrore. Vula është e formës së rrumbullakët me diametër 30mm në të cilin është i shtypur teksti: Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "Komunalno/Komunale" Tuz.

Në kapitullin IV Veprimtaritë e Shoqërisë – Shoqëria kryen veprimtari komunale të parapara me Ligj mbi kualifikimin e veprimtarisë.

Në kapitullin V Organizimi i brendshëm–Me aktin për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës përcaktohet: emrin e formave organizative; vendet e punës dhe numri i kërkuar i ekzekutorëve; lloji dhe niveli i arsimimit; përvoja e punës; kushtet e veçanta në përputhje me ligjin; punët me kompetenca dhe përgjegjësi të veçanta dhe çështje të tjera me rëndësi për organizimin e brendshëm dhe kryerjen e punëve brenda veprimtarive të Shoqërisë.

Në kapitullin VI Përfaqësimi dhe prezantimi - Me shoqëri drejton Themeluesi në mënyrë dhe me kushte të përcaktuara me Vendim dhe këtë Statut të Shoqërisë përmes organit drejtues dhe udhëheqës dhe ata: Bordit të drejtorëve dhe Drejtorit ekzekutiv.

Në kapitullin VII Informacionet dhe marrëdhëniet me publikun – Puna e Shoqërisë është publike. Shoqëria është e obliguar që rregullisht të njoftojë Themeluesin mbi punën e vet, pasqyrat kontabiliste, veprimet dhe punët e revizionit në mënyrën dhe kushtet e përcaktuara me ligj.

Në kapitullin VIII Sekreti i punës – Me sekretin e punës nënkuptohen dokumentet dhe të dhënat e përcaktuara me vendim të Bordin e drejtorëve, në pajtim me ligj, zbulimi i të cilave për personat e paautorizuar do të dëmtonte interesat dhe aktivitetet e Shoqërisë.

Kapitulli IX Aktet e Shoqërisë - Aktet e Shoqërisë janë Statuti, rregulloret dhe vendimet që rregullojnë në mënyrë të përgjithshme çështje e caktuara, përvèç nëse parashikohet ndryshe me ligj.

Në Kapitullin X Ndryshimet dhe plotësimet e Statutit– Vendimin për ndryshimet dhe plotësimet e Statutit sjell Bordi i Drejtorëve me propozimin e Drejtorit ekzekutiv të Shoqërisë, me pëlqimin e Themeluesit.

Në Kapitullin XI Përfundimi i Shoqërisë– Shoqëria pushon së funksionuari në raste dhe në kushtet e përcaktuara me ligj.

Kapitulli XII Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare - Aktet e përmendura në nenin 35 të këtij Statuti do të miratohen jo më vonë se gjashtë muaj pas datës së regjistrimit të Shoqërisë në Registrin Qendror të subjekteve afariste. Deri në miratimin e akteve të reja të përgjithshme nga paragrafi 1 i këtij nenit, zbatohen aktet e përgjithshme të Shoqërisë që janë në fuqi. Me hyrjen e këtij Statuti në fuqi, Statuti i deritanishëm bëhet i pavlefshëm “Komunalno / Komunale Tuz” 06/19-1 datë 10.10.2019. Ky Statut hyn në fuqi, pas miratimit nga ana e Bordit të Drejtorëve.